



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

14.08.2013

Prillogaritja	Numri i Broj	Shtypje	Vlera
Org. broj		Prilog	Vrednosit
01-013/1686			

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 15 dhe 16 lidhur me nenin 13 dhe 14 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr 2003/14 dhe në bazë të dispozitave të nenit 11 të Ligjit për ndryshimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr 2003/14, Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për elementet themelore të Planit Rregullues Urban nr pr. 02/05 nr rendor 41 si dhe nenit 40.2 pika g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 2008/28, dhe nenit 11.2.2 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01- 013/491 të datës 21.04.2011, dhe mbështetur në kriteret e Planit Zhvillimor Urban të Komunës së Vitisë, të datës 28.12.2010 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 02.08.2013 aprovon këtë:

## V E N D I M

PËR SHPALLJEN E SHQYRTIMIT PUBLIK TË PLANIT RREGULLUES URBAN PËR ZONËN VERIORE TË QYTETIT TE VITISË

### I.

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë SHPALL shqyrtimin publik të Planit Rregullues Urban për zonën Veriore të qytetit të Vitisë në mbështetje të Vendimit për hartimin e këtij plani nr. 01-013/302 të datës 14.03.2012.

### II.

Të drejtë pjesëmarrje në shqyrtimin publik kanë të gjithë qytetarët e komunë, si dhe subjektet tjera të interesuara dhe të prekura nga procesi i hartimit dhe zbatimit të këtij plani.

### III.

Shpallja e shqyrtimit publik të bëhet së paku në tri gazeta të përditshme dhe në mjete tjera të informimit së paku 8 ditë para shqyrtimit publik.

### IV.

Pyetjet, vërejtjet sugjerimet, komentet (verbale dhe me shkrim) mund ti drejtohen ekipit për përcjelljen e shqyrtimit publik drejtpërdrejtë ose përmes Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Vitisë.

### V.

Shqyrtimi publik do të organizohet në Shtëpinë e Kulturës “ Gursel e Bajram Sylejmani” në Viti, dhe do të zgjatë 30 ditë.

### VI.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit .

### VII.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi i dërgohet:

1. Drejtorisë për Urbanizëm,
2. Në dosje të Kuvendit
3. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

Skenderbe Hebibaj

